

Çka është Sistemi Bonus-Malus?

Sistemi Bonus-Malus është një sistem i cili rregullon nivelin e primit të sigurimit të automjetit, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit (policëmbajtësit).

Secilit të siguruar në Kosovë, që ka kontratën (policën) e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia me afat të paktën një vit, niveli i primit i caktohet sipas shkallëve të sistemit bonus-malus. Të gjithë mbajtësit e polisave të cilët nuk kanë shkaktuar aksidente brenda një viti do të përfitojnë nga bonusi i cili do të zvogëloj shkallën e primit të sigurimit të tyre për vitin e ardhshëm.

Rëndësia e këtij sistemi është se nga Bonusi do të përfitojnë shoferët e mirë dhe të disiplinuar dhe ata që janë të kujdesshëm në trafik dhe në të njëjtën kohë nëpërmjet Malusit shoferët e papërgjegjshëm që shkaktojnë aksidente do të jenë në disavantazh.

Bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia, BQK ka miratuar rregulloren për zbatimin e sistemit Bonus-Malus. Shih: https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Rregullore%20p%C3%ABr%20zbatimin%20e%20sistemit%20bonus%20malus.pdf



Zbatimi i sistemit Bonus Malus bëhet në bazë të informacioneve të gjeneruara nga **Qendra e Informative e Sigurimeve** e cila menaxhohet nga "Byroja Kosovare e Sigurimit" (BKS) apo informacioneve nga subjekte tjera të pranueshme për BQK-në. Siguruesit obligohen të aplikojnë këtë rregullore vetëm për rastet e lëshimeve të policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për personat fizikë, ndërsa zbatimi i sistemit bonus malus për personat juridikë rregullohet nga vetë siguruesit ose Byroja Kosovare e Sigurimit. E drejta për një shkallë të caktuar të primit (bonus/malus) lidhet me të siguruarin, përkatësisht policëmbajtësin dhe nuk kalon te pronari i ri.

